

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIIN)

Intimiteti prehës / *el-Uns* / الأُنْسُ

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ tha:

"وَإِذَا سَأَلَكَ عِبَادِي عَنِّي فَإِنِّي قَرِيبٌ"

"Kur robërit e Mi të pyesin për Mua (O Muhamed), Unë vërtet jam afër." (el-Bekare, 186)

Intimiteti që sjell prehje ose *uns*-i ka të bëjë me afërsi.¹ Kjo ka tri nivele:

Niveli i parë është *uns* me shenja në rrugë², gjë që ka të bëjë me:

- Ndjesinë e ëmbëlsisë në *dhikr*³
- Të ushqyerit me të dëgjuar,⁴ dhe

¹ *Uns* është një gjendje shpirtërore në të cilën afërsia ndaj Allahut rezulton me një ndjenjë rehatie dhe ëmbëlsie që mbush zemrën, duke mos i lënë hapësirë vetmisë ose tëhuajtjes. Reflektimi për madhështinë e Tij, veçanërisht për hijeshinë e Tij, dhe kushtimi ndaj një jetë të devotshme çon në këtë gjendje. Gjuhësisht *uns* vjen nga rrënja foljore e kohës së shkuar 'enese', që do të thotë 'gjeta prehje në shoqërinë e ...'. Thuhet se edhe fjala 'insaan' (njeri) vjen nga rrënja 'enese', meqë njeriu është një genie shoqërore ose 'nesije', që do të thotë 'harroi'. Sepse Ademi ﷺ harroi dhe pasardhësit e tij janë harrestarë.

² Provat, shenjat, dhe dëshmitë që Zoti na i vë në rrugë. Këto mund të jenë shenjat e Tij të folura në Kuran, ato të krijuara në univers, gjendjet që Ai i lejon t'i përjetojë zemra e ndjekësit të shtegut të pastrimit shpirtëror, si dhe të kuptuarit e shpirtit të fryteve të besimit e të dëgjueshmërisë. Të gjitha këto forcojnë besimin e ndjekësit të shtegut të pastrimit shpirtëror dhe shërbejnë si shenja udhëzuese për shtegtarin.

³ Ti s'mund të gjesh prehje në shoqërinë e dikujt pa kaluar kohë me të.

⁴ Të ushqyerit e *nefsit* (unit) me dijen e përcjellë të Shpalljes dhe të dëgjuarit vetëm të Allahut në të gjitha zërat dhe rastet dhe, rrjedhimisht, arritja e devotshmërisë (*rabbaanijjeh*) nëpërmjet kësaj.

- Njohjen e shenjave⁵

Niveli i dytë është *uns* me dritën e zbulimit. Ky është lloji i *uns* që tejkalon të parin. Ky *uns* është i mbushur me pasion intensiv dhe rrihet nga valët e *fanaa*-s (vetasgjësimit). Ky është *unsi* që mbërtheu mendjet e disa njerëzve duke ua hequr aftësinë për ta rimarrë veten dhe duke i nxjerrë jashtë kufijve të dijes. Lidhur me këtë, na është përcjellë duaja e pejgamberit ﷺ: “(O Allah) Të lus të më japësh mall (*shewk*) për takimin me Ty pa kaluar nëpër vështirësi që dëmtojnë a nëpër sprova që devijojnë.”⁶

Niveli i tretë është *uns* i tretjes në *shuhuud* (të parë; pjesëmarrje) të pranisë hyjnore. Asgjë s’mund ta shprehë thelbin e kësaj, ta përkufizojë saktë ose ta njohë krejtësisht natyrën e saj.⁷

⁵ Një zemër e kujdesshme do ta udhëzojë shikimin, dëgjimin dhe të gjitha shqisat drejt penetrimit në botën e të veçantave, të imazheve dhe të të kuptuarit e realiteteve ose domethënive të të gjitha këtyre shfaqjeve. Një zemër e kujdesshme s’do të ndalojë vetëm te implikimet e dukshme të fjalëve, por, pa shpërfillur të dukshmen, do të marrë nga thesaret e urtësisë që të tjerët nuk i njohin. Mirëpo, duhet të ketë përshtatje (balancim), jo kundërthënie mes të dukshmes dhe kuptimeve të nxjerra. Imam Ibn el-Kajjim jep shembuj në *Medaarixh el-Saaliqin* lidhur me këto shenja të holla. Për shembull, ai përmend se kërkesa (kushti) për pastërtinë e trupit dhe të teshave në namaz tregon për kërkesën e pastërtisë së zemrës në arritjen e shpërblimit dhe të dobisë së plotë. Njësoj, nëse personi duhet të kthehet nga *kibla* me trupin e tij, atëherë as zemra e tij nuk bën të shpërqendrohet nga Ai të cilin e lut.

⁶ Shejhu (el-Harawi) këtu po përshkruan një gjendje shpirtërore vibrante mes nivelit të parë dhe të fundit të *uns*. Në këtë fazë, përjetimet shpirtërore mund ta kaplojnë ndonjë me mendje të dobët dhe t’i shkaktojnë dehje shpirtërore ose së paku ta pamundësojnë të ruhet gjatë këtyre prurjeve shpirtërore (*waridaat*). I këtilli mund të bëhet aq i guximshëm me Zotin sa të shprehë thënie që përbëjnë mohim (*kufi*) të pastër. I këtilli, pra, mund të mos u përmbahet kufijve të dijes. Shejhu përmend këtë që t’i paralajmërojë ndjekësit e shtegut të pastrimit shpirtëror për këto rreziqe në shteg. Sigurisht, më të mëdhenjtë prej ndjekësve të këtij shtegu, si el-Kharki, es-Sekati, el-Xhunejd dhe të ngjashmit me këta kaluan këto faza pa u lëkundur, për shkak të fuqisë mendore që kishin, dijes së shëndoshë dhe, çka është më vendimtare, suksesit që u dha Zoti i tyre.

⁷ Si zakonisht, shejhu e bën *fanaa*-në (vetasgjësimin) nivelin e fundmë në çdo shkallë (stacion). (Ju lutemi t’i shihni diskutimet e mëparshme rreth *fanaa* dhe *bekaa*).